



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL II/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 26.02.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani

Z. Bashkim Ndrecaj

Z. Brahim Curri

Z. Alban Berisha

Z. Shefket Kolgeci

Z. Xhemajl Kabashaj

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj. Shqipe Ramaj

Z. Lirim Qatani

Z. Reshat Selimaj

Z. Ardian Kotorri

Z. Bexhet Kuçi

Z. Aziz Bytyqi

Z. Gazmend Gashi

Znj. Bardha Gashi

Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi

Z. Jeton Rrakaqi

Z. Arbërim Basha

Z. Dardan Berisha

Znj. Marigona Gashi

Znj. Florie Bytyçi

Z. Sami Hajdari

Znj. Albana Bytyqi

Z. Osman Selimaj

Z. Leonard Shala

Z. Dugagjin Palushi

Znj. Laureta Tafaj

Z. Gëzim Kryeziu

Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë
Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Habibe Bytyqi
Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuar në vitin 2019 dhe vitin 2020 për shfrytëzim në vitin 2021;**
- 5. Njoftim për planifikimin e planit të prokurimit për vitin 2021;**
- 6. Raporti vjetor i zyrës së prokurimit për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2020;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi – përshëndet të pranishmit,dhe i njofton me rendin e ditës.

Bashkim Ndrecaj – përshëndet të pranishmit. Kam kërkesë për një pike të rendit të ditës. Ka qenë propozim edhe i Kryetarit në seancën e dhjetorit,që ta emërojmë shtëpinë e shëndetit me emrin e humanistit Rexhep kuçi.

Kryetari – kjo ka procedure,seancën e radhës merret vendimi në Asamble.

Kryesuesi – e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi – kemi një informim nga zyrtari ligjor për ju.

Avni Bytyqi - njofton antarët e Kuvendit se duhet të mbushin formularin për deklarinimin e pasurisë.

Pika 1. .Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike;

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe e hap debatin.

Xhemajl Kabashi – përshëndet të pranishmit.Më intereson ta di se kur janë ndërpre këto kontrata?Mundësisht të nxirret një rregullore e brendshme,që mos ti ipet një operatori ekonomikë më shumë se një hektar,në mënyrë që sa ma shumë njerëz të konkurojnë dhe të marrin parcella.Ky ishte shqetësim si anëtar i asamblesë dhe i komisionit.

Kryetari – përshëndet të pranishmit.Ne e zbatojmë ligjin.Disa kontrata janë shkëputë dhe ne e kemi obligim ti qesim.Është komisioni i formuar nga asambleja ,dhe ai vendos kujt do t’ia jap.

Leonard Shala – përshëndet të pranishmit.Pajtohem me parafolësin.Zona po shkon duke u përfunduar dhe kanë mbet pak parcela.Unë nuk pajtohem që 6 parcela me iu nda një operatori ekonomikë.

Gëzim Kryeziu – përshëndet të pranishmit.A ka komision që shkon i verifikon këto.Është ni rast që thotë se ka mi punsu 400 puntor,e nuk i ka as 40 puntor.

Kryetari – po ka komision që janë themelu nga asambleja komunale.Janë dy komisione,njëri prej asamblesë dhe njëri prej qeverisë.Kjo kontratë është shkëput në vitin 2016,ka pas procedura gjyqësore.

Gëzim Kryeziu – kush është ai komision?

Agim Bylykbashi – Është e vërtetë që qeveria ka formu një komision për mbikqyrjet e investimeve në zonën industriale dhe agrozonë dhe unë jam kryetar i komisionit.Ne jemi në përfundim e sipër të raportit ,i cili do ti dorëzohet kryetarit me rekomandime të të gjitha parcelave.

Gëzim Kryeziu – kush janë anëtarët e komisionit prej asamblesë?

Agim Bylykbashi – nuk ka antar prej asamblesë.Jemi pesë antar.

Gëzim Kryeziu – më intereson të di,a ka ndonjë raport për ata që i kanë marrë ?

Agim Bylykbashi - thash që jemi në përfundim të raportit.

Nexhat Ramadani – përshëndet të pranishmit.Kryetari nuk jep kurrëfar përgjigje.Pyetja nga Leonardi dhe Xhenajli ishte:a ekziston mundësia që Kuvendi të merr vendim që këto parcela mos ti ipen një personi,por këto parcela ti ipen më shumë operatorëve ekonomikë.Kryetar ju thoni që në 2016 është ndërpre kontrata .Përse prej 2016 nuk janë dhanë në shfrytëzim këto prona,por është prit viti 2021?Cila është politika e juaj ndaj bizneseve?A do të kishte qenë më mire që në bazë të sugjerimeve,që të merrni vendim që tu mundësohet ma shumë bizneseve të marrin parcela?

Kryetari –nuk kem bazë ligjore me ja kufizu të drejtat për konkurim.Ne e zbatojmë ligjin dhe e qesim në ankand publik.I kemi komisionet,i kemi përfaqësuesit politik,le të vendosin se kujt do ja japin.

Nexhat Ramadani – Nuk mora përgjigje.Pyetja ishte:A kemi të drejt që ta marrim një vendim të tillë në Kuvend?

Avni Bytyqi – ne e kemi prur një projekt-vendim për mi zhvillu procedurat e konkurimit të hapur për 5 apo 6 parcela, mundemi me prur edhe për 20, mirëpo nuk pretendohet që ka mi marrë një operator ekonomikë. Kompetencë e komisionit është ti vlerësojë ofertuesit,dhe mbi bazën e ofertuesëve ata konstatojnë se sa prona i duhet ofertuesit për ta zhvilluar atë aktivitet të biznesit të cilin e ka propozuar.

Alban Berisha – përshëndet të pranishmit.Prej momentit që është shpallë zona, zone industriale prej Ministrisë së Tregtisë,A jemi tu e zbatu ligjin me përpikmëri?pyet zyrtarin ligjor.Kryetar,në fillim të mandatit ke thënë që kemi me themelu s’bashku një komision për verifikimin e pronave,që aty ku nuk është investu mi marrë.Më vje mire që ja ka nis,mirëpo premtimi ka qenë në fillim të mandatit.Ndoshta nuk mund ti përmbushim të gjitha kërkesat,por të paktën mund të jemi më realist për shumë biznese tjera.

Kryetari – edhe një here po them që është formu një komisin nga asambleja dhe kjo nuk është kompetence e Kryetarit.

Avni Bytyqi – qështjen që e ngriti Albani, ligji për zonat ekonomike dhe aktet nënligjore jetë kompetencë e Komunës që ta themelojë një komision dhe ta jep pronën në shfrytëzim, sikur që e kemi dhënë para 2014-tës.

Alban Berisha – unë jam i kënaqur si shkon puna, a jemi të obligum mi zbatu aktet nënligjore të Ministrisë së tregtisë.

Avni Bytyqi – kemi qen të obligum, dhe jemi të obligum ti zbatojmë.

Dardan Berisha – përshëndet të pranishmit. Çdo seancë kemi pas prona në dhënie në shfrytëzim. Mendoj që edhe ne e kemi një pjesë të fajit. Pyes drejtorin e financave, a i është marrë prona ndonjë pronari, duke parë si pretekst mosinvestimin në zone?

Kryetari – po, ju ka marrë x personit me vendim të gjykatës dhe ju ka dhanë dy kompanive në shfrytëzim.

Kryesuesi – e hedh në votim pikën 2.

Me 1 apstenim Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Jeton Rrakaqi – përshëndet të pranishmit. Ne si grup parlamentar i kemi shpreh qëndrimet tona për gurëthyes në seancat e kaluara. Ne qëndrojmë kundër dhënies në shfrytëzim të pronave.

Nexhat Ramadani – me sa e di me 21 tetor kemi dhënë pëlqimin për këtë sipërfaqe për gurëthyes, dhe tash kemi të bëjmë me një sipërfaqe që lidhet me atë pjesë. Dua sqarime nga drejtori. Pse kjo sipërfaqe ka mbet e ndame, dhe sipërfaqet që kanë pas ma herët këta operatorë, a janë të njejtat apo janë zgjeru? Në parim jemi për, mirëpo kërkojmë sqarime.

Kryetari – njerëzit kur punojnë ka mundësi edhe me bo gabime. Ne e kemi qit në Asamble. Është Asambleja komunale dhe komisioni që vendos, dhe ne jemi në parim me zbatu rregulloren dhe ligjin.

Nexhat Ramadani – si zakonisht Kryetari nuk jep përgjigje. A ka mundësi drejtori të an jap sqarime të cilat i kërkoja.

Emrush Bytyqi – përshëndet të pranishmit. Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronave, duke u bazu në vendimin e Asamblesë, i ka zhvillu procedurat dhe janë përzgjedh fituesit. Kemi 5 kontrata të nënshkruara. Sa i përket kërkesës së re që ka ardh, bëhet fjalë për pjesën e parcellës në Grapin e madh në Studenqa. Sipërfaqja është 7 ha dhe ka licencë për shfrytëzimin e gurit.

Kryesuesi – e hedh në votim

17 për, 7 kundër, Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuar në vitin 2019 dhe vitin 2020 për shfrytëzim në vitin 2021;

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Shqipe Rama – përshëndet të pranishmit. Dua një sqarim, pse kaq shumë mjete ka të bartura, dhe për paga dhe medijtë të QKMF-së dhe arsimi i mesëm, çka do të bëhet me këto mjete 50.000 dhe 6.000 euro?

Fadil Kryeziu – si zyrtar financiar jep këto sqarime. Te pjesa e pagave të QKMF-së llogariten këto që punojnë jasht orarit të punës, d.m.th janë të ndara 50.000 euro. Te arsimi i mesëm janë mjete të 2019-tës të cilat po barten. Ai gjithëashtu sqaron edhe pse kanë mbetë kaq shumë mjete.

Kryetari – e kam obligim të ju tregoj asambleistëve,që kemi 134.000 euro borgj.Pagesat janë bo para afatit,mirëpo qeveria e Kosovës ka pas probleme me paga,dhe i kanë marrë prej Thesarit.Duhet të gjejmë mundësinë ti paguajmë obligimet ndaj kompanive.

Fadil Kryeziu – si zyrtar financiar sqaron më hollësisht.

Dardan Berisha – pothuaj gjithë këto mjete janë aloku në rrugë dhe asnjë në sport dhe kulturëTe ndërtimi dhe meremetimi i shkollave,a mundeni me specifiku ,ku detalisht .Te aktivitet kulturore,Festari a do të mbahet?

Fadil Kryeziu – unë e kam vetëm si kod buxhetor,dhe nuk mund të jap emra.

Kryetari – do të renovohet shkolla te lagjja e Sopëve në Duhël,shkolla në fshatin Bushec dhe shkolla në Grejçec.

Xhemajl Kabashi – po nëse Komuna kishte pagu para datës 24,a ishin heq mjetet?

Fadil Kryeziu – po.

Xhemajl Kabashi –.Dua ta kujtoj që edhe juve ju kan mbet mjete shumë,sepse gjat kohës kur ishim në pushtet shumë keni koment.

Kryetari – e ceki edhe zyrtari financiar që tre mujt e fundit mjetet nuk mund të shfrytëzohen.

Bashkim Ndrecaj – te rruga “Sokol Ahmeti”,a ki me punu atë rugë Kryetar?

Kryetari – jep përgjigje.

Bashkim Ndrecaj – ish kan mire që në Maqitevë të bëhet ndriçimi.

Kryetari – ndriçimi publik vazhdon nëpër fshatra.

Kryesuesi – e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Njoftim për planifikimin e planit të prokurimit për vitin 2021;

Kryesuesi – e elaboron këtë pike.

Pika 6. Raporti vjetor i zyrës së prokurimit për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2020;

Kryesuesi – e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Leonard Shala – fasadimi i objekteve kolektive te ndërtesa e kaltër dhe banesa pranë sheshit ,thuhet : afati i mbylljes së kontratës në muajin e 12-të.Unë nuk shoh që është fasadu ndonjë banesë.

Kryetari – ndoshta është bo ndonjë gabim sepse kanë me u ndërru kulmat.

Leonard Shala - Në mandatin e kaluar pe shoh të planifikume një fushë sportive në fshatin Tërrnje.Në 20217-tën janë nda 37.000 euro,janë investu në fushë.Kam thënë që ka me u ndërtu shkolla në Tërrnje sepse ka qenë emergjnte.Mos të bëhen këso gabime sepse planet dhe planifikimet duhet me qenë afatgjata.

Pika 7. Pyetje dhe Pergjegjej

Gëzim Kryeziu – U bënë disa muaj që nuk thirret komisioni i pronave.A është ky komision vetëm letër?Duhet me fillu me komisionin.

Kryesuesi - cakton takimin e komisionit për të marten në 10,Salla e bordit.

Shefket Kolgeci – përshëndet të pranishmit.Kërkoj nga Asamblea, që të merr vendim që ato rrënoja te podrumi të rrënohen dhe të bëhet ni parking.E di që ka kontest gjyqësor,por deri në momentin që vendos gjykata ,të shfrytëzohet për parking sepse është e nevojshme.Pyet drejtorin e Shërbimeve Publike për kanalizim në fshatin Vraniq,ku ka mbërri puna.

Kryetari – atë vendim nuk kem drejt me marrë në Asamble,sepse është e privatizuar.

Shefket Kolgeci – nuk dihet edhe sa do të zgjasë vendimi nga gjykata,për atë edhe kërkova që të shfrytëzohet për parking.

Enver Shabani – jep përgjigje.

Bashkim Ndrecaj – Kryetar,rruga e Reshtanit u prish krejt.Nëse është pjesë e Komunës duhet me rregullu.

Kryetari – e dini që nuk lejohen procedurat 2-3 muajt e pare. Është kompetencë e Ministrisë,mirëpo për me i mbulu gropat do të mbushet me kubëza.

Alban Berisha – A është e vërtetë që rrugët magjistrale janë të ministrisë?

Kryetari – jep përgjigje.

Elmaze Bytyqi – më 26 mars,u lëshu një urdhëresë për biznese.Më duket shumë e vrazhdë ,dhe nëse ka mundësi që kjo urdhëresë të zëvendësohet me një vendim.

Kryetari – secili e kanë obligim me pastru para pronave të veta.Unë e kam marrë një vendim që ma lejon ligji.

Dardan Berisha – a ka mundësi një raport prej drejtorisë së arsimit për gjendjen aktuale të pandemisë,dhe sa janë duke u mbajt masat.I drejtohet drejtorisë së shëndetësisë,kolegët asambleist ,si Bashkimi e të tjerë që kanë ngrit disa qështje,është shqetësuese.Më intereson të di çka është bo me vjedhjen e barnave në podrumin e QKMF-së?

Kryetari - ka qenë dezinformat,kjo nuk ka ndodh te ne,ka ndodh në Prizren.Kemi gjendje të qetë dhe stabile në arsim,ndërsa sa i përket QKMF-së, unë then që gjendja është e mire mirëpo kemi mungesë të mjekëve që kanë shku në specializim.

Jeton Rrakaqi – pasi gjendja është e mire,pse kaq shpesh je i pranishëm në Ambulant?sipas disa informative,gjithë shefat atje kanë dhënë dorëheqje.

Kryetari – Nuk di që ka dhënë dikush dorëheqje.Kam të drejt me shku.Shkoj për vizit,kontroll.

Jeton Rrakaqi – ka dy vite ku rruga në Fidanishte,duke fillu nga ambulanta,gjendja ska ndryshu.Se di a janë marrë masa ndaj punëkryesit.

Kryetari – është garancioni ,procedurat vazhdojnë.

Jeton Rrakaqi – ka tre vite qe ne e kemi kry si komision i ankesave për emertimin e rrugëve.Çka po ndodh?

Kryetari – jep përgjigje.

Rilind Krasniqi – përshëndet të pranishmit.Para dy viteve është dhënë ni tender për mirëmbajtjen e rrugëve lokale në vlerë afërsisht 500.000 euro.A është duke u bo sanimi i rrugëve apo janë duke i përfitu ato para,a ka naj komision qe i shikon?

Kryetari – është kry kontrata vitin e kaluar e cila ka qenë për tre vite,janë letrat,mundeni mi kërku.

Laureta Tafa – X personit në zonën industriale iu ka shkëput kontrata. Pa e dhënë gjykata vendimin ka ardh parcela në Asamble dhe ne e kemi dhënë në shfrytëzim,a kemi pas të drejt apo jo?

Avni Bytyqi – per rastin qe ju po pyetni kjo qeshtej ka qen duke u trajtuar ne Gjykatën per qeshtje administrative dhe Ligji per konteste administrative thot se padia kunder vendimit ne procedur administrative nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit dhe ne si Komune deri me tani jemi ne rregull.

Takimi përfundoi: **11:20**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj